



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE

Newsletter | Maj 2025

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE TAKOHET ME KRYEMINISTRIN BRITANIK



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Genti Gazheli, së bashku me ministrin e Brendshëm Ervin Hoxha mirëpritën në Portin e Durrësit Kryeministrin britanik **Sh.T. Z. Keir Starmer** në vizitën e parë të një kryeministri të Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri.

Dogana Shqiptare prej vitesh kanë një bashkëpunim të shkëlqyer me Ambasadën Britanike në Tiranë e në mënyrë të veçantë me **Home Office International Operation** dhe **HMRC**, në funksion të modernizimit të sistemeve të monitorimit të kufijve.

Një projekt i financuar nga Home Office International Operation ka mundur vendosjen e sistemeve të kamerave dhe leximit automatik të targave në pikat e kalimit kufitar, duke rritur efikasitetin e luftës së organeve ligjzbatuese në parandalimin e trafikëve të paligjshme dhe ndalimin e dërgesave cash të padëklaruar sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkëpunimi mes organeve ligjzbatuese në Portin e Durrësit në operacione të përbashkëta mes Administratës Doganore dhe Policisë së Shtetit e asistuar nga programet e Home Office dhe HMRC është vlerësuar si shembull në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

HAPEN NEGOCIATAT PËR KAPITUJT E GRUPIMIT 3 KAPITULLI 29 BASHKIMI DOGANOR

Këshilli i Bashkimit Europian ka miratuar më **8 Maj** qëndrimin e përbashkët të BE-së për çeljen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë mbi 8 kapituj të rinj të Grupimit të 3: Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithpërfshirëse, duke shënuar një tjetër hap të rëndësishëm përpara në negociatat e Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Europian. Ky grupim përfaqëson rritjen gjithpërfshirëse për mirëqenie dhe përfshin tetë fusha, mes të cilave edhe Kapitullin 29, Bashkimi Doganor.

Në dokumentin e publikuar nga Komisioni Europian pas përfundimit të Konferencës së Katërt Ndërqeveritare midis Bashkimit Europian dhe Shqipërisë në **Bruksel**, për Kapitullin 29 - Bashkimi Doganor, nënvizohet se, BE-ja mirëpret përparimin e Shqipërisë në përafrimin me **acquis** e BE-së në fushën e legjislacionit doganor. BE-ja vëren me kënaqësi nivelin e lartë të përafrimit të Shqipërisë me **acquis** e BE-së, veçanërisht në lidhje me borxhin doganor dhe garancitë doganore, vlerësimin doganor, procedurat doganore për import dhe eksport, procedurat speciale përveç transitit, Operatorët Ekonomikë të Autorizuar, si dhe kontrollet e bagazheve të pasagjerëve ajrorë dhe detarë.

Acquis i bashkimit doganor përbëhet nga një legjislacion i cili është drejtpërdrejtë i detyrueshëm për shtetet anëtare. Ai përfshin Kodin Doganor të BE-së dhe dispozitat e tij zbatuese, nomenklaturën e kombinuar, tarifën e përbashkët doganore dhe dispozitat për klasifikimin e tarifave, lehtësimin e taksës doganore, pezullimet e detyrimeve dhe kuotat e caktuara të tarifave, si dhe dispozita të tjera, si ato për kontrollin doganor të mallrave të falsifikuara, lëndët e para për prodhimin e drogave, eksportimin e mallrave kulturore, si dhe për ndihmën e ndërsjellë administrative në çështjet doganore dhe të tranzitit.



DOGANA DIGJITALE



Drejtorja e Përgjithshme e Doganave është bashkuar nismës së Qeverisë për të digjitalizuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset, nëpërmjet platformës **E-Albania**.

Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës procedurale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit.

Vetëm gjatë muajit Maj 2025 nga Administrata Doganore Shqiptare janë miratuar **632 shërbime online**.

RRITET BASHKËPUNIMI DOGANOR NË RAJONIN E ADRIATIKUT

Administratat Doganore të **Italisë, Shqipërisë, Kroacisë, Malit të Zi dhe Sllovenisë** u takuan në **13 Maj**, në Trieste për të riafirmuar angazhimin e tyre për forcimin e bashkëpunimit rajonal në zonën e Adriatikut.

Duke pasur parasysh rolin në rritje të Detit Adriatik, si një korridor jetësor për tregtinë ndërkombëtare, veçanërisht midis Bashkimit Europian dhe vendeve fqinje dhe duke njohur sfidat e lidhura me të në operacionet doganore dhe kundër mashtrimit, Administratat pjesëmarrëse ranë dakord mbi nevojën për një koordinim më të thellë strategjik dhe operacional.

Duke pranuar rezultatet pozitive të arritura në kuadër të Projektit Adriacustoms të bashkëfinancuar nga BE në kuadër të **Programit OLAF BE-Anti-Mashtrim** dhe me qëllim rritjen e mëtejshme të shkëmbimit të ekspertizës dhe praktikave më të mira, Administratat doganore kanë miratuar dokumentin "Adriacustoms: Një Udhërrëfyes për Bashkëpunim të Përmirësuar në Rajonin e Adriatikut" si kornizë për bashkëpunimin e ardhshëm.

Objektivat kryesorë të këtij angazhimi përfshijnë krijimin e një rrjeti ekspertësh për të mbështetur dialogun dhe koordinimin e strukturuar, planifikimin dhe kryerjen e operacioneve të përbashkëta në fushat me interes të përbashkët, shkëmbimin e informacionit për menaxhimin e përbashkët të riskut dhe profilizimin e përbashkët të riskut, harmonizimin e strategjive të kontrollit dhe përhapjen e praktikave më të mira, si dhe zhvillimin e programeve të avancuara të trajnimit për të forcuar kapacitetin institucional. Administratat pjesëmarrëse synojnë gjithashtu të marrin në konsideratë përgatitjen e përbashkët të propozimeve të projekteve për dorëzim sipas instrumenteve përkatëse të financimit të BE-së.



VIZITË E INSTITUTIT PËR STUDIMET E LARTA TË MINISTRISË SË BRENDSHME FRANCEZE NË DOGANËN E QAFË THANËS

Instituti për Studime të Larta të Ministrisë së Brendshme Franceze, **IHEMI**, zhvilloi një vizitë studimore në Shqipëri, me qëllim njohjen me sfidat në fushën e sigurisë dhe drejtësisë të vendit tonë. Pjesë e kësaj vizite ishte dhe prezantimi me strukturat e Policisë dhe Doganave në pikën e kalimit kufitar të Qafë Thanës.

Gjatë këtij inspektimi, **80 zyrtarët** e lartë të Institutit për Studimet e Larta të Ministrisë së Brendshme Franceze panë në terren organizimin dhe punën operacionale në këtë pikë doganore, ku u krye dhe një demonstrim i funksionimit të skanerit për makinat.

Ky Institut organizon çdo vit për pjesëmarrësit e tij (parlamentarë, funksionarë të lartë, oficerë të lartë, magjistratë, të zgjedhur lokalë, funksionarë të sektorit privat, etj.) trajnime të nivelit të lartë për identifikimin dhe analizat e sfidave kryesore të sigurisë dhe drejtësisë. Ky sesion kombëtar, i cili ka nisur në shtator 2024, zhvillon dhe trajton çdo muaj, një temë të veçantë, deri në përmbylljen e tij në **Qershor 2025**.

